

roristički..., III, 516-519, 940; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998. godini*, <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

### Xhevat (Salih) Shala

(20.12.1972, shqiptar nga Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevati me bashkëshorten Bahrijen dhe fëmijët e tyre jetonin në bashkësi me vëllezërit e Xhevatit, Ismetin dhe Ganiun. Që nga viti 1997, Xhevati me vëllezërit dhe familjarët e tjerë e mbanin rojën në fshat. Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohen regjistrimet], ata aderuan në UÇK. Gjatë ofensivës së shtatorit të forcave serbe, Xhevati me njësitin e vet gjendeshin në një pozicion në fshat. Në datën **25.09.1998**, rreth orës 15:00, Xhevati e mbante pozicionin te vendi i quajtur *Derëgllavë/Svinjska glava*. E qëlluan kur doli nga istikami për ta vëzhguar situatën [**Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić**]. I vëllai Ganiu me disa ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur në të njëjtën mbrëmje në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, më 20.09.1999, mbetjet mortore të Xhevatit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin e lindjes.

**Burimet:** deklarata S.S, FDH-36610; SHFDUÇK, *Feniksët...*6, 285-289; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Dragoslav (Ilija) Tadić

(26.04.1962, serb nga Bashaidi, komuna e Kikindes, punëtor, një fëmijë, pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Goran (Dušan) Živadinović

(4.09.1969, serb nga Bogdanci, komuna e Sokobanjes, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Slavomir (Desimir) Bojanić

(15.02.1970, serb nga Baçka Pallankë, punëtor, një fëmijë, pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Aleksandar (Branislav) Pantović

(10.11.1973, malazez nga Vrbasi, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Ognjen (Ilija) Petrović

(2.05.1975, serb nga Novi Sadi, një fëmijë, pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dragoslavi, Gorani, Slavomiri, Aleksandri dhe Ognjeni kanë qenë pjesëtarë të forcave rezervë të NJSA-së në përbërje të MPB-së. Për detyrë e kishin përcjelljen dhe sigurimin e pjesëtarëve të Misionit Verifikues të OSBE-së. Në datën **25.09.1998**, ata që të gjithë, së bashku me shoferin Zoran Blagojevićin, e kanë përcjellë një grup vëzhguesish në **Likoc/Likovac**. Në kthim, në udhëkryqin e rrugës për Obri të Epërme/Gornje Obrinje, makina e tyre në kthesë me rrotën e djathtë të fundit ka shkelur mbi minën kundërtank. Të gjithë gjetën vdekjen në vend, përpos Zoranit.

Gorani u varros më 26.09.1998 në varrezat e Sokobanjes, Slavomiri më 27.09.1998 në varrezat e fshatit Kasidolli, komuna e Pribojit, Dragoslavi më 27.09.1998 në Baçka Pallankë, ndërkaq Aleksandri më 27.09.1998 në varrezat në Vrbas.

**Burimet:** deklarata D.T, FDH-21143; deklarata B.P, FDH-31703; deklarata S.B, FDH-27293; deklarata G.M, FDH-24714; SMIP, *Teroristički...*, III, 516, 940; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 15, 27, 51, 53, 68; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

### Zymer (Tan) Tahiri

(16.06.1946, shqiptar nga Aqareva/Ovçarevo, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Zymeri me bashkëshorten Haven, djemtë dhe vajzat jetonin në Aqarevë/Ovçarevo. Zymeri e ka strehuar familjen në fshatin Baks më 22.09.1998. Pastaj, u kthye në pozicionin e vet. Ka rënë më **25.09.1998** në bjeshkën *Mali i Shkozës/Škoza* [**Aqarevë/Ovçarevo**] gjatë betejës me forcat serbe. Po atë ditë, tre familjarë të afërm të tij e kanë varrosur Zymerin në pyll. Në datën 20.10.1998, familjarët e kanë rivarrosur në varrezat e fshatit. Pas lufte, në muajin shtator të vitit 1999, mbetjet mortore të Zymerit u transferuan në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Aqarevë/Ovçarevo.

**Burimet:** deklarata K.T, FDH-32457; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.